



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 7331 Prot.

Fier më 18.06 .2025

Projekt - Vendim

Nr. 60 Dt. 18.06 .2025

“Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik , për pasuritë e paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit “Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit” ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt....../...../2025, I paraqitet për shqyrtim materiali nga Komisioni i Shpronësimi dhe vlersimit paraprak ,ngritur me urdhër të Kryetarit me nr.151 datë 22.04.2025 “Për ngritjen e komisionit të shpronësimit dhe vlerësimit paraprak për pasuritë e paluajtshme,pronë private që preken nga realizimi i projektit “Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit”, në lidhje me listën emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për pasuritë e paluajtshme, që preken nga realizimi i projektit “Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit” ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier për përfundimin e miratimit të procesit të shpronësimit për interes publik.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015,”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma “b”, Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr.89, datë 03/02/2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 54, gërma “k”, ekzekutivi :

Propozon :

1-Të miratojë tabelën me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për pasuritë e paluajtshme, që preken nga realizimi i projektit “Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit”,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier sipas tabelës bashkëlidhur ;

2-Ngarkohet ekzekutivi I Bashkisë Fier për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit pranë Agjencisë Shtetërore Për Shpronësimin , MIE , Tiranë ;

Komisioni I shpronësimit dhe vlerësimit paraprak për interes publik

Esmeralda Kapllanaj

Pranvera Toska

Arbion Behari

Jetion Gjeka

Erald Tavanxhi

Silvana Basha

Ilsidor Prifti

Dr. Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit

P.Çina

KRYETARI

Armando SUBASHI

NË MUNGESË E ME AUTORIZIM

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Martin Dodi

